



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 101, datë 26.02.2020**

**PËR**  
**MIRATIMIN E VLERËSIMIT DHE PIKËZIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE, SI**  
**DHE TË LISTËS SË KANDIDATËVE MË TË MIRË QË KONKURROJNË PËR NË**  
**GJYKATËN E LARTË, NGA RADHËT E JURISTËVE TË SPIKATUR, NË**  
**POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE, TË**  
**SHPALLUR ME VENDIMIN NR.108, DATË 09.07.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË**  
**GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikat 6, 7 dhe 8, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit të tij nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, si dhe në Vendimin e tij nr.209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, mbi propozimin e relatorit të çështjes,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraparak të kandidatit z.{...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraparak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Miratimin e listës me kandidatët më të mirë, si më poshtë:
  1. Z.{...}
3. Zhvillimin e intervistës me kandidatin z. {...} më datë 27.02.2020, ora 10:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**